

Në bazë nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-2012 , nenit 8 të Rregullores mbi themelimin e mardhënies së punës në KRU "Hidromorava"-sha Gjilan, dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01 /2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, KRU "Hidromorava"-sha Gjilan shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Nj.O.Viti pranë KRU "Hidromorava"-sha Gjilan.

- 1 (një) Operator në FPU. Letnicë, NjO.Viti ,
2. 1 (një) Lexues të Ujëmatësve - inkasant, në NjO.Viti
3. 1 (një) Mjeshter në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjiellësit NjO.Viti.

1.Titulli i pozitës: Opertor në FPU. Letnicë

Numri i ekzekutuesve:

- Një /1/ njësia operative në Viti;
- Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të caktuar
- Orari i plotë: 40 orë në javë.
- Paga bruto: 502 €

Përgatitja shkollore:

- Kualifikimi shkollor: Shkolla e Mesme
- Njohja e punës me kompjuter MS Word & Exel

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kujdeset për mbarëvajtjen e procesit të punës në Fabrikën e Ujit;
- Kujdeset për kuotën shtypjes së ujit;
- Kujdeset për kulaitetin – klorizimin e ujit në FPU;
- Evidenton ecuritë kryesore të prodhimit gjatë procesit të punës;
- Bën pranim dorëzimin e ndërrimit sipas radhës me operatorët;
- I pëgjigjet Menaxherit të Njo. dhe Menaxherit për cilësi të ujit.

2. Titulli i pozites: Lexues të ujëmatësve

- Numri i ekzekutuesve:
- Një /1/ njësia operative në Viti;
- Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë caktuar
- Orari i plotë: 40 orë në javë.
- Paga bruto: 502 €

Përgatitja shkollore:

- Kualifikimi shkollor: Shkolla e mesme;
- Njohja e punës me kompjuter MS Word & Exel;

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Bënë leximin e ujëmatësve në sektorin privat dhe shoqëror;

- Jep vërejtje hargjuesve për eliminimin e defekteve të ujëmatësve;
- Zbulon dhe i lajmëron hargjuesit e ujit të cilët në ndërtesat e veta kanë lokale afariste;
- Shënon ndërrimin e pronarëve në ujëmatës;
- Shënon hargjuesit e ri dhe hargjuesit të cilët janë të lidhur në mënyrë ilegale (egër);
- Jep vërejtje Konsumatorëve për mirëmbajtjen e pusetave për leximin e ujëmatësve;
- Shënon ujëmatësit e çmontuar dhe të montuar, si dhe datën dhe gjendjen e ujëmatësit;
- Gjendjet e lexuara i regjistron në databazë;
- Arketon mjetet nga konsumatorët shtepiak dhe institucional;
- Mjetet e grumbulluara të nesërmen i dorzon në arkën kryesore të bashkangjitur në specifikacion;
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të menaxherit të njësisë punuese Viti.

3. Mjeshter në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjesit

Numri i ekzekutuesve:

- Një /I/ njësia operative Viti;
- Kohëzgjatja e kontratës: Kohë të caktuar
- Orari i plotë: 40 orë në javë.
- Paga bruto: 502 €

Përgaditja Shkollore:

- Kualifikimi shkollor: Shkolla e mesme
- Patent Shoferi kategoria "C"

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Kryen punën i pavarur me udhëzimin e përgjegjesit në rikonstruimin e rrjetit a sipas nevojës edhe në zgjerimin e rrjetit;
- Bën vendosjen dhe lidhjen e gypave kur për to paraqitet nevoja;
- Monton të gjitha llojet e gypave në rrjetin e ujësjesit;
- Bën pranimin e materialit të nevojshëm për punë;
- Bën lidhjen e rrjetit sekondar në rrjetin ekzistues si dhe bënë evitimin e defekteve në rrjetin e ujësjesit kyqjet dhe çkyqjet në rrjet;
- Bën montimin dhe ndërrimin e ujëmatësve në rrjetin e ujësjesit;
- Punon në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjesit;
- Drejton te gjitha automjetet e njësisë sipas nevojës;
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të menaxherit të njësisë punuese Viti.

Çdo kandidat (aplikues) për pozitat e lartëckura duhet t'i komplettoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm si vijon:

1. Dëshmi të kualifikimit shkollor, fotokopje e noterizuar;
2. Dokumentin e identifikimit;
3. CV;
4. Çertifikatën se nuk është nën hetime dhe nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale.

Çertifikatën mjekësore (për shkak të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve pjesëmarrës në konkurs në fund të procedurës rekretuese e njejt/a do të kërkohet vetëm nga kandidati i pranuar në punë).

Aplikim bëhet online përmes këti e-mailit zyrtar puna@kru-hidromorava.com.

Konkurset publikohen në ueb faqen zyrtare të kompanisë KRU Hidromorava
<https://kru-hidromorava.com/konkurse/>

Afati i aplikimit është 15 ditë, nga dita e shpalljes publike të konkursit në portalet lokale , në linkun e shpalljeve publike të kompanisë puna@kru-hidromorava.com edhe atë nga data 26 Mars 2024 deri më datë 09 Prill 2024 në ora 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën që i plotesojnë kushtet e Konkursit ftohen për intervistë dhe njoftohen për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së testimit me shkrim përmes postës elektronike dhe individualisht .

Kryeshafi Ekzekutiv

Ymer Salihu

